



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:272154
Datë: 25.04.2024
Numri i dokumentit: 05617903

C.nr. 1000/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Florian Krasniqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.A, të cilin e përfaqëson avokat H.A, me adresë në "...", kundër të paditurës "...", me seli në Prishtinë, me objekt kontesti anulimin e vendimit dhe obligimin e punësimit, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor – publik, me datë 04.04.2024, mori dhe me datë 25.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET** në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit A.A, me të cilën ka kërkuar që të: anulohet akti administrativ i drejtorisë për Hetime të Brendshme dhe Verifikim të së kaluarës të Drejtorisë së Përgjithshme të P.K, me numër 150 HKpu 2019, i datës 12.09.2019, të obligohet e paditura që ti mundësoj punësimin paditësit në P.K dhe të obligohet e paditura që paditësit t’ia paguajë fitimin e humbur për kohën sa nuk ka punuar, në shumën si në vijim: gjashtë paga si kadet policor, secila në shumën prej 300,62 euro, gjithsejtë si kadet policor shumën prej 1,803,72 euro për periudhën 11.11.2019 deri 10.05.2020; njëzet e katër paga si polic i ri, secila në shumën prej 362,50 euro, apo shuma e përgjithshme si polic i ri prej 8,700.00 euro, për periudhën 11.05.2020 deri 10.05.2022 shumën prej 3,443.56 euro për periudhën 11.05.2022 deri 01.02.2023; dhjetë paga si zyrtar policor me ligjin e ri të pagave në shumën prej 5,679.20 euro për periudhën 01.02.2023 deri 19.11.2023 dhe katër paga si polic i lartë në shumën prej 2,949.70 euro për periudhën 20.11.2023 deri me datë 04.04.2024, e në total shumën prej 22,576.18 euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.**

A r s y e t i m

Paditësi, me datë 21.11.2021, pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi kundër të paditurës me objekt të kontestit anulimin e aktit administrativ të të paditurës, obligimin për tu punësuar tek e paditura, dhe pagesën e pagave në mënyrë retroaktive në formë të fitimit të humbur. Në padi

ndër të tjera paditësi ka deklaruar se, në cilësinë e aplikantit kishte aplikuar në konkurs tek e paditura me datë 16.04-10.05.2018, dhe pasi që i ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore me datë 15.09.2018 i është nënshtruar testit me shkrim, të cilin e ka kaluar me sukses 72 pikë, dhe është ftuar ti nënshtrohet testit të aftësive fizike. Tutje ka theksuar se, ka kaluar edhe të gjitha testet fizike dhe është ftuar për intervistë me gojë të cilën e ka kaluar me sukses duke tubuar gjithsejtë 82.20 pikë, dhe pastaj është ftuar për të iu nënshtruar testit mjekësor dhe atij psikologjik. Tutje ka theksuar se, pas përfundimit me sukses të të gjitha testeve e paditura ka filluar periudhën e verifikimit të të kaluarës, e cila kryhet në teren, dhe verifikimin të kaluarës kriminale, ku ka rezultuar se paditësi ka pasur gjatë jetës së tij një lëndë në cilësinë e ankuesit dhe 3 lëndë kundërvajtje, njëra për rrip të sigurisë, njëra për parkim të automjetit në vend të ndaluar për parkim dhe e fundit për mos respektim të shenjave apo urdhrave të personit zyrtar. Tutje ka theksuar se, si rezultat i hetimeve të kryera, drejtoria për hetim të brendshëm ka marre vendim që kundërvajtja për mos respektim të shenjave apo urdhrave të personit zyrtar paraqet pengesë për paditësin për tu rekomanduar pozitivisht për pranim në punë si polic sipas kodit të etikës dhe udhëzimit administrativ 02/2018, neni 5, paragrafi 5, dhe neni 9, paragrafi 1, pika 1.5 të këtij udhëzimi administrativ. Tutje ka theksuar se, kundërvajtja në fjalë, për mos respektim të shenjave apo urdhrave të personit zyrtar, fillimisht gabimisht është cilësuar si vepër penale, fakt që mund të kuptohet edhe nga hedhja e kallëzimit penal dhe se në kohën kur është kryer verifikimi i të kaluarës për paditësin, paditësi nuk ka pasur kallëzim penal të ngritur, pasi është hedhur nga prokurori, dhe se paditësi asnjëherë nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, dhe se kundërvajtjet të gjetura në historinë e paditësit nuk paraqesin pengesë për tu punësuar në P.K. Ka shtuar se meqenëse paditësi ka kaluar të gjitha testet e parashtruara me sukses të plotë, nuk ka qenë i dënuar për vepër penale dhe ndaj tij nuk është iniciuar procedurë e bazuar penale, shihet se paditësi nuk bie ndesh me kodin e etikës dhe moralit shoqëror dhe se akti administrativ me nr. 150Hkpu2019, i datës 12.09.2019, është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe ato kushtetuese. I ka propozuar gjykatës që padia e paditësit të aprovohet si e bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura me përgjigje në padi ka deklaruar se, vendimi i atakuar me padi është marre konform dispozitave në fuqi dhe pretendimet se vendimi është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, dhe këto pretendime nuk janë provuar me prova përkatëse. Tutje ka theksuar se vendimi për refuzimin e ankesës së paditësit ka qenë i drejtë dhe i bazuar në ligj, për arsye se në bazë të raportit përfundimtar të verifikimit është vërtetuar se njëjti nuk i ka plotësuar standardet e caktuara të etikës të parapara me nenin 5, pika 5, dhe neni 9, par 1, nën paragrafi 1.5 dhe 1.7 të udhëzimit administrativ 02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës. I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë në tërësi si të pabazuar. Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Gjykata, bazuar në propozimet e palëve ka zhvilluar procedurën e të provuarit, dhe në këtë çështje juridike kontestimore ka administruar provat si në vijim: Vendimi i komisionit të ankesave i datës 13.11.2019, aktvendimi PP.nr. 1242-5/14 datë 05.06.2014, dokumenti – prova e titulluar information, datë 11/2019, lista e rezultateve meritore datë 13.11.2018, shpallja e rezultateve të testit psikologjik, datë 04.09.2019, rezultatet e kontrollimit mjekësor, datë 04.09.2019, rezultatet e kontrollimit mjeksor, datë 04.09.20.2019, rezultatet e testit për

shkathtësi fizike, datë 07.11.2018, lista e rezultateve të testit me shkrim, datë 09.10.2018, lista e kandidatëve të cilët nuk janë kualifikuar për zyrtarë policor, ankesa e datës 06.11.2019, ankesa e datës 06.11.2019, raporti përfundimtar për verifikim me rekomandim lidhur me kandidatin A.A për procesin e punësimit, datë 12.09.2019.

Gjykata, pasi bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, bazuar në nenin 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim si: LPK), erdhi në përfundimin se padia e paditësit është në tërësi e pabazuar, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Në bazë të të gjitha provave dhe deklarimeve nga palët ndërgjyqëse, vërtetohet se ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese se paditësi ka aplikuar për punësim në pozitën zyrtar policor në Policinë e Republikës së Kosovës dhe se me rastin e aplikimit për punësim iu kishte nënshtruar të gjitha testeve përkatëse, testime këto të cilat i kishte kaluar me numrin e mjaftueshëm të pikëve të kërkuara sipas kritereve të përcaktuara nga ana e vet të paditurës. Këto fakte po ashtu vërtetohen lista e rezultateve meritore datë 13.11.2018, shpallja e rezultateve të testit psikologjik, datë 04.09.2019, rezultatet e kontrollimit mjekësor, datë 04.09.2019, rezultatet e kontrollimit mjekësor, datë 04.09.20.2019, rezultatet e testit për shkathtësi fizike, datë 07.11.2018, lista e rezultateve të testit me shkrim, datë 09.10.2018.

Ndërsa, nga raporti përfundimtar për verifikim me rekomandim lidhur me kandidatin A.A për procesin e punësimit, datë 12.09.2019, vërtetohet se njësitë për rekrutim dhe seleksionim pranë të të paditurës nuk kishte rekomanduar paditësin për tu punësuar në Policinë e Kosovës. Në këtë raport, nga njësitë për rekrutim dhe seleksionim pranë të të paditurës, në pikën pesë të raportit ishte konstatuar se bazuar në certifikatat për evidencat e të kaluarës, paditësi nuk kishte ndonjë akuzë në gjykatën përkatëse ku është lëshuar certifikata, e ndërsa në pikën gjashtë të këtij raporti ishte konstatuar se paditësi në gjykatën për kundërvajtje është dënuar për kundërvajtje në shumën prej 200 euro, pasi kishte qenë duke drejtuar automjetin nën ndikim të alkoolit prej 1.48 promila. Po ashtu në këtë raport ishte konstatuar se ndaj paditësit me datë 16.05.2014 ishte iniciuar rasti me numër 2014-CF-1048 dhe se prokuroria themelore në Ferizaj me vendimin PP.nr. 1242/5/14 kishte hedhur kallëzimin penal. Nga të gjitha këto shkelje, raporti përfundon me faktin se paditësi nuk rekomandohet për tu punësuar në Policinë e Kosovës.

Nga ankesa e datës 06.11.2019 vërtetohet se paditësi ndaj raportit për mos rekomandim dhe ndaj listave për kandidatët të cilët nuk janë rekomanduar, kishte ushtruar ankesë tek organi kompetent i të paditurës.

Nga vendimi i komisionit të ankesave i datës 13.11.2019, vërtetohet se komisioni i ankesave tek e paditura kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit dhe kishte lënë në fuqi raportin e përgjithshëm të verifikimit të së kaluarës me numër 150 Hkpu2019 të Drejtorisë për Hetime të Brendshme dhe Verifikim të së kaluarës. Komisioni i ankesave tek e paditura kishte arsyetuar se, paditësi nuk i plotëson kriteret dhe standardet e kërkuara për tu bërë zyrtar policor, sepse gjatë fazës së verifikimit të së kaluarës është dokumentuar se i njëjti nuk i ka plotësuar standardet e caktuara sipas kodit të etikës të parapara me nenin 5, pika 5 dhe nenin 9, pika 1.5 dhe 1.7 të udhëzimit administrativ 02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës.

Bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar dhe në provat e bashkëngjitura nga pala paditëse, gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar. Kjo për faktin se pala paditëse gjatë zhvillimit të procedurës nuk ka arritur që të vërtetoj faktet vendimtare mbi bazën e të cilave do të vërtetohej bazueshmëria e kërkesëpadiës, gjegjësisht, se nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor nuk është arritur të vërtetohet se e paditura me rastin e zhvillimit të konkursit të ketë shkelur procedurat në raport me paditësin. Gjykata vlerëson se nga raporti përfundimtar për verifikim me rekomandim lidhur me kandidatin A.A për procesin e punësimit, datë 12.09.2019, e paditura ndër të tjera kishte konstatuar se bazuar në evidencat e të kaluarës, paditësi ka qenë i dënuar me kundërvajtje në shumën prej 200 euro, pasi që i njëjti me datën 16.05.2014, ishte hasur duke e drejtuar automjetin pa patentë shofer dhe duke bërë gara me veturë, ku pas shenjë stop nga Policia i njëjti nuk e kishte ndaluar veturën, dhe ishte duke e drejtuar automjetin nën ndikim të alkoolit në organizëm.

Bazuar në kohën kur paditësi ka aplikuar për punësim, Gjykata gjen se procedura e punësimit tek e paditura P.K, në kohën kur paditësi kishte aplikuar për tu punësuar si zyrtar policor, ishte e rregulluar me Udhëzimin Administrativ 02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës. Me nenin 5, paragrafi 5 të këtij udhëzimi administrativ parashihet: *Kandidati për punësim në Polici duhet t'i plotësojë standardet e kërkuara të përshtatshmërisë në pajtim me standardet e caktuara me Kodin e etikës, të mos jetë i dënuar për ndonjë vepër penale, apo ndaj tyre të mos jetë iniciuar ndonjë procedurë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare.* Ndërsa me nenin 9 paragrafi 1, pika 1.5 dhe 1.7 të udhëzimit administrativ parashihet që: *Kandidatët që aplikojnë për zyrtarë policorë duhet t'i plotësojnë kriteret themelore si në vijim: 1.5. të mos jetë i dënuar për ndonjë vepër penale sipas nenit 5, paragrafi 5 të këtij udhëzimi administrativ, 1.7. të ketë integritet personal dhe vlera të larta etike.* Referuar dispozitave në fjalë rezulton se e paditura me udhëzimin administrativ, ka caktuar si kriter për punësim që kandidati përkatës duhet të plotësojë standardet e kërkuara të përshtatshmërisë në pajtim me standardet e caktuara me Kodin e Etikës, e po ashtu i njëjti duhet të ketë integritet personal dhe vlera të larta etike. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate nga vet mënyra se si është përcaktuar kriteri që kandidati të ketë integritet, vlerësimi se çka përbën integritet personal dhe vlera të larta etike është në diskrecionin e të paditurës, andaj e paditura bazuar në evidencat e të kaluarës së paditësit, duke marrë për bazë të gjitha kundërvajtjet dhe iniciimin e rasteve penale që ishin të evidentuara në evidencat e të kaluarës, ka vlerësuar se paditësi nuk e plotëson kriterin e integritetit personal dhe vlerat e larta etike. Gjykata vlerëson se përderisa është në diskrecionin e të paditurës që të vlerësojë nëse kandidati përkatës i plotëson kriteret e standardit të integritetit personal, nuk mund të përcaktohet në procedurë gjyqësore nëse kundërvajtjet dhe procedurat e iniciuara ndaj paditësit, e që janë të evidentuara në evidencat e të kaluarës, e bëjnë paditësin kandidat me integritet ose jo.

Gjykata po ashtu vlerëson se, paditësi ka pretenduar se kundërvajtjet e kryera nuk përbëjnë shkak për mos rekomandim për punësim në pozitën zyrtar policor, megjithatë sipas vlerësimit të gjykatës, siç është arsyetuar më lartë, e paditura ka të drejtën e vlerësimit të integritetit të kandidatëve për punësim. Thënë këtë, paditësi nuk ka paraqitur asnjë pretendim ose provë që e paditura me të njëjtat kundërvajtje e ka rekomanduar ndonjë kandidat tjetër për punësim, dhe paditësin me të njëjtat kundërvajtje të kryera mos ta rekomandojë, andaj mbi bazën këtyre

thënieve, gjykata vlerëson se përderisa e paditura ka diskrecionin të vlerësojë se cilët kandidat kanë integritet personal për tu punësuar tek e paditura, nuk është në domenin e gjykatës rishikimi i fakteve nëse paditësi ka integritet personal për tu punësuar tek e paditura ose jo. Për më tepër, në kuptim të vlerësimit të integritetit personal për punësim, paditësi në padi ka pohuar faktin se i njëjti me rastin e aplikimit për punësim tek e paditura, kundërvajtet të cilat kanë qenë të evidentuara në emrin e tij sipas evidencës së të kaluarës, nuk i ka evidentuar fare në aplikacionin për punësim.

Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se shtrirja e juridiksionit të saj mbi veprimtarinë administrative të organeve publike, në këtë rast të paditurës, ka për qëllim të garantojë parimin e ligjshmërisë dhe kontrollin gjyqësor mbi veprimtarinë diskrecionare të saj, por në asnjë mënyrë për të zëvendësuar kompetencat të cilat ekskluzivisht i janë njohur sipas ligjit të paditurës.

Në lidhshmëri me konstatimet e lartë cekura, dhe duke u bazuar në faktin se paditësi nuk ka argumentuar të jenë bërë shkelje në procedurat e konkursit në raport me paditësin, gjykata ka refuzuar edhe kërkesën e paditësit me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura që në emër të fitimit të humbur t'ia paguajë paditësit shumën prej 22,576.18 euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit. Kjo duke u bazuar në arsyet si në vijim: së pari gjykata vlerëson se kërkesat nga marrëdhënia e punës janë të ndërlidhura në atë formë që, fillimisht duhet të provohet me prova se ka ndodhur shkelja e të drejtave të punëtorit (ose kandidatit për tu punësuar), e vetëm pasi të vërtetohet një shkelje e tillë e paditura mund të obligohet nga gjykata për pagesën e kompensimit përkatës ndaj punëtorit, kjo duke u bazuar në nenin 80, paragrafi 1, pika 1.1. të Ligjit të Punës, i cili përcakton 1. Nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore, në bazë të dispozitave të këtij ligji, Kontratës Kolektive ose Kontratës së Punës, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të ekzekutoj njërën prej këtyre dëmshpërblimeve: 1.1. t'i paguajë të punësuarve kompensimin, përveç shtesave dhe shumave tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të këtij ligji, Kontratës së Punës, Kontratës Kolektive ose Aktit të Brendshëm, në shuma të tilla që gjykata i konsideron të drejta dhe adekuate, por të cilat nuk duhet të jenë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit. Së dyti gjykata sjell në vëmendje se paditësi ka qenë vetëm kandidat për tu punësuar, pra ka aplikuar në konkursin e shpallur nga e paditura dhe nuk ka krijuar marrëdhënie pune me të paditurën, andaj sipas vlerësimit të Gjykatës, është e pabazuar kërkesa e paditësit që në emër të fitimit të humbur (pagesave që do ti realizonte sikur të ishte punësuar) të detyrohet e paditura që t'ia paguajë të gjitha pagat nga dita e mos rekomandimit deri në ditën e nxjerrjes së aktgjykimit. Kjo për faktin se, meqenëse paditësi ka qenë vetëm kandidat për tu punësuar tek e paditura, nuk mund të merret si e sigurte rrethana që paditësi do ti kishte realizuar pagat nga momenti i mos rekomandimit deri në ditën e nxjerrjes së aktgjykimit, siç është kërkuar nga paditësi. Kjo edhe për faktin se, fitimi i humbur nënkupton fitimin që do të mund të pritej në mënyrë të bazuar dhe nga rrjedha e rregullt e gjërave, siç përcaktohet me nenin 173, paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, që rregullon si në vijim: 3. Gjatë vlerësimit të lartësisë së fitimit të humbur merret në konsiderim fitimi që ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas rrjedhjes së rregullt të gjërave ose sipas rrethanave të veçanta, e realizimi i të cilit është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga lëshimi që të ndërmerr veprimin.

Gjykata po ashtu ka refuzuar edhe kërkesën e paditësit me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura që paditësin ta punësoj në pozitën zyrtar policor, ngase sipas vlerësimit të gjykatës, nuk është provuar nga paditësi që e paditura të ketë bërë shkelje gjatë zhvillimit të procedurave të konkursit në raport me paditësin, e për më tepër, gjykata vlerëson se në kontestet juridike që derivojnë nga marrëdhënia e punës, përkatësisht konkurset e punës, gjykata kufizohet në vlerësimin nëse e paditura ka bërë shkelje procedurale gjatë zhvillimit të procedurave të konkursit, dhe urdhëron vetëm evitimin e shkeljes në fazën në të cilën ka ndodhur shkelja e të drejtave të punëtorit (ose kandidatit për tu punësuar), ndërsa nuk është në domenin e gjykatës obligimi i të paditurës për themelimin e marrëdhënies së punës me paditësin.

Vendimin nga pika II e dispozitivit të aktgjykimit, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta gjykata e mbështet në dispozitën e nenit 450 të LPK-së, e cila përcakton: *Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta.*

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, bazuar në nenin 160 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1000/2020, datë 24.04.2024

Gjyqtari
Florian Krasniqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.